



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIATEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 564/<sub>1</sub> prot.

Tepelenë, më 31.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 23, datë 30.03.2026**

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM NË FAVOR TË QENDRËS  
“ACEG”, NJË PJESË TË OBJEKTIT PUBLIK SHKOLLA 9-VJEÇARE “ASIM ZENELI”,  
FSHATI PROGONAT BASHKIA TEPELENË, DHE MIRATIMIT TË MARRËVESHJES SË  
BASHKËPUNIMIT QË DO TË NËNSHKRUHET PËR KËTË QËLLIM”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 54, shkronjat “e/1”, “f” dhe “k”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 901-912, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, Udhëzimin nr. 21, datë 23.08.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për përdorimin e ambienteve të institucioneve arsimore parauniversitare jashtë orarit mësimor, si edhe në vijim të relacionit të grupit të punës nr. 564 prot, datë 24.03.2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Dhënie në përdorim pa kundërsHPërblim në favor të Qendrës “ACEG”, një pjesë të pasurisë me numër 682 dhe sipërfaqe ndërtimore 507 m<sup>2</sup> të objektit shkolla 9-vjeçare “Asim Zeneli”, përkatësisht kati i dytë. Afati i përdorimit është 9 vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së huapërdorje, me të drejtë rinovimi dhe miratim të Këshillit Bashkiak
2. Miratim të marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Bashkia Tepelenë të ndjek procedurën sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe nxjerrjen e çdo akti të nevojshëm për zbatimin e tij.
5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e ligjore dhe shërbimeve Organizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Sportit dhe Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**Sekretari Këshillit Bashkiak**

**Valbona ÇELA**



Miratuar me 10 (dhjetë) vota  
Vota Pro 10 (dhjetë) vota  
Vota Kundër 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur më datë 31.03.2026

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**ARBEN GUMENI**

